


NDIHMUJINI PUNONJËSIT TUAJ TË MARRIN KUJDESIN SHËNDETËSOR ME NYC CARE



Në NYC ne besojmë se çdo njujorkez ka të drejtën të marrë kujdes shëndetësor parandalues dhe të specializuar **pavarësisht statusit të imigrimit dhe mundësisë për të paguar**. Si punëdhënës ju jeni partneri kyç në ndihmesën që punonjësit tuaj të jenë të shëndetshëm dhe të sigurt.

Ofrimi i kujdesit tërësor e cilësor ka qenë gjithnjë diçka thelbësore për sistemin e shëndetit publik të qytetit nga NYC Health + Hospitals. Ndërsa COVID-19 ka ndikuar tek të gjithë njujorkezët, impakti ka qenë më i madh tek ata që nuk kanë mundësi të përfitojnë nga kujdesi i plotë shëndetësor. NYC Care, një program për aksesin në kujdesin shëndetësor i drejtuar nga NYC Health + Hospitals, do të vijojë të shërbejë si urë mes këtyre hendeqeve me synim rritjen e shëndetit në të gjitha komunitetet e NYC, teksa vijojmë të përballemi e të lëvizim mes sfidave të kësaj pandemie. **Për të ndihmuar punonjësit tanë pa sigurim që të marrin një kujdes të përballueshëm mjekësor, tregojuni se si të bëhen anëtarë të NYC Care që sot.**

NYC Care garanton shërbime kujdesi shëndetësor me kosto të ulët apo falas për njujorkezët që nuk përfitojnë apo që nuk mund ta përballojnë sigurimin shëndetësor.

PËRSE DUHET T'JU INTERESUJË NYC CARE?

- C** Ju **kujdeseni (care)** për shëndetin e punonjësve tuaj. Ata jua mbajnë biznesin aktiv, ata ndajnë suksesin tuaj dhe ju dëshironi t'i keni të shëndetshëm.
- A** Punonjësit tuaj do të kenë *më pak* **mungesa (absences)** nga puna nëse përfitojnë nga kujdesi i rregullt, kujdesi parandalues, si p.sh. depistimet dhe vaksinat.
- R** Ju do t'i **mbani (retain)** më gjatë punonjësit në biznesin tuaj nëse ate e dinë se kujdeseni për ta dhe për shëndetin e tyre dhe të njerëzve të tyre.
- E** Ju do të rrisni **efikasitetin (efficiency)** dhe produktivitetin duke i ndihmuar punonjësit tuaj të kalojnë jetë më të shëndetshme.

**NYC
HEALTH+
HOSPITALS**

**NYC
CARE**
Your Key
to the City's
Health Care

Nisja e diskutimit për NYC Care me punonjësit tuaj

Ja një skenar i shkurtër për t'ju ndihmuar, së bashku me disa pyetje të zakonshme rreth programit.

- + Shëndeti juaj është i rëndësishëm për ne.
- + Nëse jeni i sëmurë, qëndroni në shtëpi dhe kujdesuni për veten.
- + Unë dua gjithashtu të ndaj një informacion me ju për **NYC Care**, një program që u mundëson njujorkezëve që nuk kanë apo nuk mund ta përballojnë sigurimin shëndetësor, të përfitojnë nga kujdesi shëndetësor me kosto të ulët ose falas për ta.
- + Pasi të bëheni pjesëtar i këtij programi, mund të:
 - Lini takimin e parë me mjekun e kujdesit shëndetësor parësor në dy javë a më pak.
 - Merrni mbështetje nga ekipi i kujdesit primar që përfshin infermierë, profesionistë të shëndetit mendor, ndihmësmjekë, punonjës socialë, farmacistë dhe nutricionistë.
 - Kontaktoni qendrën telefonike të NYC Care, e disponueshme 24/7, kur ju duhet ndihmë.
 - Përfitoni akses 24/7 në barna me recetë me çmim të ulët dhe rimbushje brenda së nesërme kur nevojitet.

Py: Ku mund ta përdor NYC CARE?

Pe: NYC Care aktualisht u ofron pjesëtarëve një rrjet ofruesish dhe shërbimesh në ambientet e NYC Health + Hospitals. Për një listë të vendndodhjeve të NYC Health + Hospitals telefonojini qendrës së kontaktit të NYC Care në nr. **1-646-NYC-CARE (1-646-692-2273)** ose vizitoni nyccare.nyc.

Py: A kualifikohem unë për NYC Care?

Pe: Për të mësuar nëse kualifikoheni, telefononi nr. **1-646-NYC-CARE (1-646-692-2273)** sot.

Py: Sa më duhet të paguaj për shërbimet?

Pe: Nuk ka kosto për regjistrimin, nuk ka prime dhe nuk ka tarifa mujore. Kostoja që duhet të paguani për të marrë kujdes shëndetësor bazohet në madhësinë dhe të ardhurat e familjes, duke filluar nga \$0. Për më shumë informacion, vizitoni nyccare.nyc për të parë tabelën me nivelin e tarifave.

Py: A është sigurim shëndetësor NYC Care?

Pe: NYC Care është një program kujdesi shëndetësor që mundëson një rrjet ofruesish dhe shërbimesh në ambientet e NYC Health + Hospitals në të gjithë qytetin. Ndryshe nga sigurimi shëndetësor, nuk ka kosto për t'u regjistruar, nuk ka prime dhe nuk ka tarifa mujore.

Py: Unë kam pasur sigurim shëndetësor. Ta lë dhe të regjistrohem te NYC Care?

Pe: Nëse keni aktualisht sigurim shëndetësor, mos e lini. Ata që kualifikohen për sigurim qoftë përmes punëdhënësit, qoftë përmes tregut apo përmes Medicaid, duhet të regjistrohen në programin për të cilin kualifikohen.

Py: Si mund të mësoj më shumë apo të regjistrohem në NYC Care?

Pe: Telefononi në nr. **1-646-NYC-CARE (1-646-692-2273)**. Ata flasin gjuhën tuaj! NYC Care ka lidhur partneritet me organizatat e komunitetit për të mbështetur zgjerimin dhe regjistrimin. Mund të vizitoni nyccare.nyc për të mësuar më shumë dhe për të parë listën aktuale të partnerëve të komunitetit.

Py: Si mund të marr broshurën?

Pe: Vizitoni nyccare.nyc/resources për të shkarkuar materiale në 14 gjuhë.



RUANI LIDHJET. NA NDIQNI.

Albanian_08/20

NYC
HEALTH+
HOSPITALS

